



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, KOMUNIKIMIT DHE  
PROMOCIONIT

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Korçë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2018

Lënda: Shpallje konkursi për personel ndihmësakademik me karakter mësimor

Drejtuar : **AGJENSISË SË PROKURIMEVE PUBLIKE**

**TIRANË**

Bashkëlidhur ju dërgojmë njoftimin për shpallje konkursi për personel ndihmësakademik me karakter mësimor.

Ju falenderoj për bashkëpunimin,

**REKTORI**

**Prof.dr. Ali Jashari**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, KOMUNIKIMIT DHE**  
**PROMOCIONIT**

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Korçë, më \_\_\_\_/ \_\_\_\_/ 2018

**NJOFTIM**

Bazuar në ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 66, pikat 2 dhe 4 si dhe Statutin e Universitetit, neni 43, pikat 1.a dhe 4, Universitetit «Fan S. Noli» Korçë shpall konkurs për personel ndihmësakademik me karakter mësimor si më poshtë:

**1. Laborant në Departamentin e Agroushqimit pranë Fakultetit të Bujqësisë (një vend).**

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati janë si më poshtë:

**Kriteret e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës, për të cilin konkurron.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për kryerje të veprave penale.
- Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga puna.

**Kriteret e veçanta:**

- Të ketë përfunduar studimet e larta universitare në universitete brenda ose jashtë vendit në shkencat e Kimisë.
- Të ketë notë mesatare të përgjithshme të studimeve universitare mbi 7 dhe të lëndëve të specialitetit mbi 7.
- Të ketë diplomë të ciklit të dytë në fushën përkatëse.
- Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore me dëshmi.
- Të zotërojë programet bazë të kompjuterit me dëshmi.
- Preferohen kandidatët me përvojë pune në laboratorë kimikë.
- Preferohen kandidatët që kanë kryer kurse ose kualifikime brenda ose jashtë vendit në fushën përkatëse (laboratori, menaxhim laborator, preparator).

Për pozicionin e shpallur, kandidatët konkurrues duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë për aplikim për vendin e punës
- Curriculum vitae

- Fotokopje të diplomave dhe listat e notave të noterizuara
- Fotokopje të kartës së identitetit
- Fotokopje të librezës së punës dhe/ose vërtetime të punës/ve të kryera të vërtetuara nga organet tatimore dhe të sigurimeve shoqërore
- Vlerësim nga punëdhënësi i fundit
- Vetëdeklarim mbi gjendjen gjyqësore
- Deklaratë për konfliktin e interesit

Diplomat apo certifikatat e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me vërtetimin e njohjes dhe njësimit nga MARS, sipas përcaktimit të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015, neni 92, pika 3.

Dokumentet do të dërgohen vetëm në rrugë postare, në adresën, Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, Shëtitörja “Rilindasit”.

Aplikimet e kandidatëve do të pranohen brenda 15 ditëve (kalendarike) nga data e publikimit të njoftimit për shpalljen e konkursit në Buletinin e Njoftimeve Publike. Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet brenda 7 ditëve nga përfundimi i afatit për dorëzimin e dosjeve.

**REKTORI**  
**Prof.dr. Ali Jashari**